



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 24.17.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË INSTITUTIT
GJYQËSOR TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR
MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Institutit Gjqësor të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Ajtene Llapashtica (Udhëheqëse ekipi) dhe Burbuqe Idrizi (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Samir Zymeri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	12
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	17
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	18
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	21
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	22

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetorë të Institutit Gjyqësor të Kosovës¹ për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit², të datës 16/03/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Kryesuesin e Këshillit dhe Drejtorin me stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Më 03 shkurt të vitit 2017 është dekretuar Ligji Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë (AD). Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji Akademia është trashëguese juridike e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Megjithatë ne, në këtë raport do ta përdorim emërtimin Instituti Gjyqësor i Kosovës, pasi që ky auditim mbulon vitin 2016, periudhë para aprovimit të këtij Ligji.

² Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit".

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Kryesuesit të Këshillit- auditimi 2016**

Kryesuesi i Këshillit Drejtues i Institutit Gjyqësor (Akademisë së Drejtësisë) të Kosovës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Kemi audituar PFV-të e IGJK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116, nr. 04/L-194, dhe ligji nr. 05/L -063) dhe Rregullores së MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinionin

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Drejtori i IGJK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e

pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Këshillit Drejtues si dhe Drejtori i IGJK-së janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të IGJK-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

IGJK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMPPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116; Ligjin nr. 04/L-194; dhe ligji nr. 05/L -063;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e plotë dhe e saktë, andaj ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur për PFV-të e IGJK-së.

Edhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm, janë përmbushur në tërësi nga IGJK-ja, nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për IGJK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollat. Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të plotësuar për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në IGJK lidhur me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Po ashtu cilësia e raportimit menaxherial dhe zbatimit të rekomandimeve nga IGJK ka shënuar progres. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga IGJK e pasqyron këtë situatë.

Një numër i kufizuar i dobësive të qeverisjes që ekzistojnë brenda IGJK-së kanë të bëjnë me mjedisin e kontrollit, si mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse dhe mbulimi i pozitës së drejtorit të IGJK-së me ushtrues detyre. Si institucion me numër të vogël të stafit, ndarja e detyrave dhe përgjegjësi paraqet sfidë për IGJK-në.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2015 të IGJK-së ka rezultuar me katër (4) rekomandime kryesore. IGJK ka treguar progres në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit të kaluar. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, tri (3) rekomandime janë zbatuar plotësisht, ndërsa një (1) rekomandim ka mbetur i pa zbatuar, edhe pse IGJK-ja ka bërë përpjekjet e saja dhe ka ndërmarrë veprime përmes shkresave të bëra në Ministrinë e Administratës Publike (MAP). Si pasojë ende ekziston çështja e njëjtë që ndërlihet me mospërputhjet e titullit të vendit të punës ndërmjet akt emërimit dhe listës së pagave (Payroll). Për të mos përsëritur çështjen/rekomandimin e njëjtë, përpjekjet e Kryesuesit të Këshillit Drejtues duhet të vazhdojnë deri në zbatimin e tij.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për IGJK-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit.

Çështja 1 - Pyetësi i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi identifikuar se:

- IGJK nuk ka të hartuar strategjinë gjithëpërfshirëse zhvillimore, megjithatë objektivat strategjike për vitin 2016 i kishte paraparë në Programin e Punës për vitin 2016. Arsyeja e mos hartimit të strategjisë kishte të bënte me procesin e transformimit të IGJK-së në Akademinë e Drejtësisë (AD). Megjithatë, aktualisht IGJK e transformuar në AD është në fazën e hartimit të strategjisë zhvillimore; dhe
- Proceset efektive të monitorimit lidhur me progresin e objektivave konsiderohen si të vendosura nga ana e IGJK-së, mirëpo dëshmitë e ofruara në mbështetje të këtyre konkluzioneve janë të dobëta.

Ndërsa veprimet e ndërmarra për adresimin e çështjeve të identifikuar nga vet-vlerësimi i vitit 2015 kanë treguar rezultat, pasi IGJK ka hartuar një regjistër për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve.

- Rreziku** Mungesa e planit strategjik zhvillimor si dhe proceset joefektive të monitorimit, pamundësojnë identifikimin e çështjeve të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e efikasitetit dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara.
- Rekomandimi 1** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë hartimin e strategjisë zhvillimore dhe një plan/proces të dokumentuar dhe efektiv të monitorimit të arritjes së objektivave. Po ashtu të siguroj se është rishikuar plotësimi i saktë i pyetësorit të vetëvlerësimit, dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive dhe ekziston dokumentacioni mbështetës për këtë proces.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit IGJK operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.3.1 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

IGJK ka organogramin ku janë të paraqitura qartë struktura organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse. IGJK ka një raportim të mirë menaxherial, financiar mbi shpenzimet dhe realizimin e buxhetit duke aplikuar proceset e llogaridhënies dhe të raportimit në baza javore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, IGJK nuk i plotëson kriteret për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Në bazë të kërkesës së IGJK-së, Njësia e Auditimit të Brendshëm në kuadër të MF-së me datën 14.03.2017 kishte përfunduar një auditim të brendshëm për proceset e zhvilluara për periudhën janar-dhjetor 2016. Raporti i kishte ofruar menaxhmentit një pasqyrë të qartë mbi nivelin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme. Pas pranimit të raportit, nga menaxhmenti është përgatitur plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit.

IGJK ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP). Megjithatë ekzistojnë disa dobësi në vijim të cilat duhet të adresohen. Mbulimi i pozitave kyçe me ushtrues detyre përtej afatit të paraparë ligjor si dhe menaxhimi i pasurisë mbeten sfida për institucionin.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	571,884	445,207	438,994	504,318	592,399
Granti i Qeverisë -Buxheti	571,884	433,846	427,699	491,689	587,439
Donacionet e jashtme		11,361	11,295	12,629	4,960

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte reduktuar për 126,677€. Reduktimi i buxhetit ishte bërë pas rishikimit buxhetor me vendime të Qeverisë. Në vitin 2016, IGJK ka përdorur 99% të buxhetit final ose 438,994€, me një përmirësim prej 4% krahasuar me vitin 2015.

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	571,884	445,207	438,994	504,318	592,399
Pagat dhe Mëditjet	204,384	189,384	183,460	188,959	177,099
Mallrat dhe Shërbimet	351,000	246,045	245,783	303,551	384,949
Shërbimet komunale	16,500	9,778	9,751	11,808	8,500
Investimet Kapitale	-	-	-	-	21,851

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Me vendim të Qeverisë⁴ për kursime buxhetore në fund vit ishte bërë shkurtimi buxhetor prej 15,000€ në kategorinë paga dhe mëditje. Tepricë të mjeteve në fund të vitit kishte si pasojë e mos plotësimit të numrit të stafit me dy pozita të lira;
- Në kategorinë mallra dhe shërbime buxheti final ishte reduktuar për 104,955€ me vendim të Qeverisë⁵, ndër arsyet kryesore është mos fillimi me kohë i programit për trajnimin fillestar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve që mbahet nga IGJK⁶;
- Shkurtime Buxhetore prej 6,722€ për Shërbimet Komunale ishin bërë fillimisht me rishikim buxhetor për vlerën 1,500€ si dhe më pastaj me vendim të Qeverisë për 5,222€; dhe
- IGJK ka pranuar grante nga donatorët e jashtëm vlerën prej 11,361€, prej tyre donacion i bartur nga UNICEF-i vlera prej 5,845€ dhe donacion i vitit nga GIZ 5,449€. Shuma e donacionit ishte shpenzuar kryesisht për të financuar mbështetjen për trajnimet profesionale që mbahen nga IGJK. Ndërsa donacionet të cilat janë menaxhuar nga vet donatorët vlera prej 107,559€ nuk kanë rrjedhë përmes llogarisë së Thesarit, dhe janë raportuar direkt nga donatorët.

⁴ Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për kursime buxhetore i datës 28.12.2016.

⁵ Me vendim të Qeverisë ishte shkurtuar buxheti prej 116,316€ te kategoria mallra dhe shërbime por pjesa prej 11,361€ ishte mbuluar nga Donacionet.

⁶ Procedurat e rekrutimit të Gjyqtarëve ishin në proces nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial.

3.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe nga ana e IGJK-së kanë të bëjnë me verifikimin dhe ndryshimet në listën e pagave, rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me Thesarin. Në kuadër të shpenzimeve për paga dhe mëditje përfshihen pagat e stafit të IGJK-së, si dhe pagesat për anëtarët e Këshillit Drejtues të IGJK-së.

Numri i aprovuar i stafit për vitin 2016 ka qenë 25 pozita, mirëpo në fund vit kanë mbetur dy (2) pozita të lira.

Çështja 2 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre - Prioritet i lartë

E gjetura Ligji për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës 03L/149 si dhe rregullorja nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese thekson se në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, Ushtruesi i Detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.

Në IGJK dy (2) pozita kyçe për institucionin mbulohen me UD duke tejkalluar afatin e lejuar për mbajtjen e tyre. Pozita e Drejtorit të IGJK-së mbulohet me UD që nga data 14.07.2015, ndërsa pozita Udhëheqës i programit për trajnime të vazhdueshme nga data 01.08.2016.

IGJK ka bërë katër (4) herë shpalljen publike për rekrutim të pozitës së Drejtorit mirëpo ka pasur mungesë të kandidatëve/konkurrentëve të mjaftueshëm për përzgjedhjen e tij.

Ndërsa për pozitën udhëheqës i programit për trajnime të vazhdueshme procedurat e rekrutimit janë në proces të zhvillimit.

Rreziku Mbulimi i pozitave kyçe me UD për një periudhë më të gjatë se tre (3) muaj mund të kenë ndikim në cilësinë e performancës operationale dhe mosarritjen e objektivave të entitetit.

Rekomandimi 2 Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë mbulimin e rregullt të pozitave kyçe të institucionit të cilat janë me UD, duke zhvilluar procedurat sipas kërkesave ligjore.

3.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime duke përfshirë edhe shërbimet komunale në vitin 2016 ishte 255,823⁷€. Prej tyre janë shpenzuar 255,534⁸€. Këto kryesisht kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve për shërbimet e trajnimit, shpenzimet e qirasë, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve si dhe shpenzimet për vizita studimore.

Bazuar në mostrat tona IGJK ka realizuar buxhetin dhe procedurat e prokurimit në pajtueshmëri me LMFPP si dhe LPP-në.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Pasuritë

3.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë kapitale e paraqitur në PFV 2016 ishte 5,719€, ndërsa vlera e pasurisë jokapitale ishte 19,587€. Stoqet në fund vit ishin 21,222€.

Gjatë vitit 2016 IGJK, nuk ka blerë asnjë pasuri kapitale. Ne kemi rishikuar nëse procesi i mbajtjes së regjistrave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullores MF – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit dhe ekzistencën fizike të pasurive dhe kemi identifikuar çështjet si në vijim:

⁷ Buxheti final Mallra dhe Shërbime 246,045€ dhe Shpenzimet Komunale 9,778€;

⁸ Shpenzimet Mallra dhe Shërbime 245,783€ dhe Shpenzimet Komunale 9,751€

Çështja 3 – Menaxhimi i Pasurisë - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 19 “Zyrtari Kryesor Administrativ i organizatës buxhetore formon komisionin për Inventarizim të pasurisë”. Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare.

- IGJK nuk kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë, kërkesë kjo sipas rregullores;
- Programi i e-pasurisë nuk kalkulon si duhet zhvlerësimin e pasurive. Kemi vërejtur se 21 kompjuterë (llaptop) të regjistruar si pasuri në vitin 2014, nuk janë zhvlerësuar. Po ashtu 20 llaptop tjerë, të regjistruar në janar të vitit 2012 të cilat është dashur të figurojnë me vlerë neto zero, kanë ende vlerë të paraqitur në regjistra; dhe
- Blerja e një pasurie në vlerë prej 1,415€ nuk është regjistruar në regjistrin e-pasuria si dhe një pasuri e transferuar me vendim, nuk është larguar nga regjistri i e-pasurisë.

Çështja e mos llogaritjes së zhvlerësimit ishte ngritur nga IGJK-ja tek zyrtarët për menaxhimin e programit të e-pasurisë, por gjendja vazhdon të mbetet e njëjtë.

Rreziku Menaxhimi jo i mirë i pasurisë (mos themelimi i komisionit të inventarizimit, mos regjistrimi i pasurive) rritë rrezikun e përdorimit jo të mirë të pasurive apo humbjes dhe tjetërsimit të tyre. Mungesa e regjistrave të plotë dhe të saktë të pasurisë ndikon që pasuria e deklaruar në PFV të jetë mos jetë e saktë.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë që regjistrat e pasurisë të jenë të plotë dhe të përfshijnë pasurinë që e menaxhon IGJK-ja (tani AD-ja). Drejtori të formojë komisionin e inventarizimit të pasurisë me kohë me qëllim që raporti i inventarizimit t’i paraprijë përgatitjes së PFV-ve.

3.5 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 5,595€. Këto obligime janë bartur dhe janë paguar në fillim të vitit 2016. Në PFV-të e vitit 2016 janë paraqitur obligime me vlerë 3,325€, arsyeja e paraqitjes si obligime kryesisht ishte pranimi i faturave pas afatit të zotimit si dhe faturat e pranuar në vitin 2017.

IGJK ka një sistem të mirë kontrolli për menaxhimin e pagesave. Raportimi i obligimeve ishte bërë në përputhje me rregullën financiare nr.02/2013/MF.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Këshillit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:



- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryetari i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë së kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Po		
3.4 Prokurimi	Kryetari i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë se kontrollet në procesin e ekzekutimit të pagesave janë duke u monitoruar në vazhdimësi. Procesi i pagesave duhet të bëhet në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me LMFPP-në, dhe me rregullat e Thesarit.	Po		
3.5 Shpenzime jo përmes prokurimit	Kryetari i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë se në rastet e paraqitjes së nevojës për punë shtesë e cila mund të mbulohet nga stafi i brendshëm, të zbatohen procedurat e LSHC duke iu shmangur nënshkrimit të kontratave të veçanta. Mirëpo nëse ato nuk mund të mbulohen nga stafi i brendshëm, të siguroj shërbimet nga jashtë duke ndjekur procedurat e përcaktuara të Ligjit të Prokurimit Publik dhe rregullat përkatëse të thesarit.	Po		
3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	Kryetari i Këshillit Drejtues duhet të vazhdoj përpjekjet që në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të siguroj se listat e pagave (payroll) janë të përgatitura në pajtueshmëri me Akt emërimet për secilin të punësuar, përfshirë pozitën dhe koeficientin e pagesës.			JO - Edhe pas përpjekjeve të bëra nga IGJK-ja rekomandimi nuk është zbatuar pasi për këtë rekomandim nevojitet veprim edhe nga ana e MAP-it.

Shtojca IV: Letërkonfirmimi

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Besim Morina 

u.d. Drejtor i Akademisë së Drejtësisë,

Data: 02 Maj 2017, Prishtinë,